

BORGJEZI E KUQE, BORGJEZI E ZEZË:

Perceptime mbi fundin e socializmit në romanet *Dimri i madh* dhe *Koncert në fund të dimrit* të Ismail Kadaresë

ENIS SULSTAROVA¹

Abstrakt

Artikulli shqyrton dy romane të Ismail Kadaresë, *Dimri i madh* dhe *Koncert në fund të dimrit* për mënyrën se si trajtohen në letërsinë e kohës dy krizat e regjimit komunist shqiptar në vitet 1960-1970, të shkaktuara nga ndërprerja e mbështetjes prej Bashkimit Sovjetik dhe, më pas, Kinës. Në këta romane paraqitet hipoteza e fundit të komunizmit, për t’u hedhur poshtë me anë të pohimit të normalitetit të modernitetit socialist, i cili “vërtetohet” përmes panoramës së jetës së përditshme në Tiranë të personazheve pozitivë. Këta të fundit i përkasin shtresës së burokratëve dhe intelektualëve krijues, e cila ishte përfituese kryesore e revolucionit socialist. Dy romanet e paraqesin pakthyeshmërinë e komunizmit edhe përmes orientalizimit të shteteve “revizioniste”, të borgjezisë së mëparshme dhe atyre

¹ Prof. asoc. Enis Sulstarova është pedagog në Departamentin e Shkencave Politike pranë Universitetit të Tiranës.

burokratëve që ëndërrojnë të kthehen në një shtresë sunduese në socializëm, në “borgjezi të kuqe”. Romani *Koncert në fund të dimrit*, fillimisht i ndaluar, por më pas botuar në fund të viteve 1980, përmes kundërvënies orientaliste Evropë-Azi, e paraqet Shqipërinë socialiste si pjesë të pandashme të kulturës evropiane, duke i dhënë zë shpresave të një pjese të intelektualëve të kohës për hapje drejt Perëndimit, ose për një fund të mundshëm të komunizmit, që do t’i hapte rrugën “rikthimit” të Shqipërisë në Evropë.

Fjalë kyçe: *komunizëm, roman, jetë e përditshme, modernitet, orientalizëm, Evropë*

Red Bourgeoisie, Black Bourgeoisie: Impressions on the End of Socialism in Ismail Kadare’s novels, *The Great Winter* and *The Concert*

ENIS SULSTAROVA²

Abstract

The article examines two novels by Ismail Kadare, namely, *The Great Winter* and *The Concert*, in terms of the way in which the crises experienced by the Albanian communist regime in the 1960s and 1970s, which were caused by the Soviet Union’s and later China’s withdrawal of support for the regime, are reflected in the literature of the time. In these novels, the hypothesis of the end of communism is presented only to be refuted by the affirmation of the normalcy of socialist modernity, which is

² Assoc. Prof. Enis Sulstarova is a lecturer in the Department of Political Science at the University of Tirana.

“proven” through the panorama of the everyday life of the positive characters in Tirana. The latter belong to the bureaucratic and intellectual class, which was the main beneficiary of the socialist revolution. The two novels present the irreversibility of communism also through the Orientalization of the prewar bourgeoisie, the “revisionist” states, and those bureaucrats who dream of becoming a new ruling class in socialism, i.e., a “red bourgeoisie”. In *The Concert*, which was initially banned only to be eventually published in the late 1980s, the Europe-Asia opposition is deployed as an Orientalist trope also in order to present socialist Albania as an inseparable part of European culture, giving voice to the hopes of some intellectuals of the time for an opening towards the West, or for a possible end of communism, which would pave the way for Albania's “return” to Europe.

Keywords: *communism, novel, everyday life, modernity, Orientalism, Europe*

Ti do t'i biesh violinës për këtë botë, tha me vete Marku duke ecur drejt skenës me violonçelin e madh në dorë. E huaj për të, enigmatike, det xixëllimash, frikërash, që i prushit vazhdimisht era e kohës, kjo botë e regjimit komunist do të shtrihej para tij, në një gjysmërreth të pafund, një anonimat kokash, ku më të largëtat s'duken, si në rreshtat e fundit të galerive, dhe ai, në cep të saj, në tangenten fatale të kësaj bote, do t'i binte violinës gjersa të këputej e të rrëzohej përdhe pa frymë.³

³ Ismail Kadare, *Vepra letrare 7: Dimri i madh*, Tiranë: 8 Nëntori, 1981, f. 613.

I. Hyrje

Ndërprejra e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, a do të thoshte se komunizmit në Shqipëri po i vinte fundi? Te fundi i socializmit shpresonin personazhet e deklasuar të romanit *Dimri i madh* të Ismail Kadaresë. Mirëpo, dilema kishin edhe pjesëtarët e parisë komuniste. A mund të ndërtohej socializmi pa Bashkimin Sovjetik? “Ekzistenca jonë pa Bashkimin Sovjetik është absurde”,⁴ thotë në këtë vepër një anëtare e Byrosë Politike, që më pas përjashtohet nga partia. A duhej që bijtë e bijat e brezit që kishte çliruar vendin dhe kishte ndërmarrë revolucionin shoqëror, të vazhdonin edhe ata të sakrifikonin për arritjen e komunizmit, apo tani ishte koha që ata të gëzonin privilegjet e pushtetit që prindërit e tyre e ushtronin në emër të klasës punëtore? A do të vijonte revolucioni rrugën e vet, apo komunistët shqiptarë do të ktheheshin në një klasë të re sunduese, në një “borgjezi të kuqe”, siç po dukej se po ndodhte me udhëheqjen e partive komuniste në Bashkimin Sovjetik dhe në shtetet e tjera të kampit socialist në Evropë? Ndërsa ish-partizanët e kthyer në burokratë tani jetonin në shtëpitë e ish-borgjezëve të kryeqytetit, a do të merrnin ata “veset” e klasës së përmbysur? Këto mendime e mundojnë Besnik Strugën, personazhin qendror të romanit *Dimri i madh*, ndërsa gjendet në mesin e përplasjes ideologjike dhe ndërkombëtare, si përkthyes në delegacionin e Partisë së Punës në mbledhjen e 81 partive komuniste të gjithë botës që mbahet në Moskë.

Vite më vonë, shkrimtari Skënder Bermema, personazh i

⁴ Po aty, f. 277.

romanit *Koncert në fund të dimrit* i Ismail Kadarese, gjatë një vizite në Kinën socialiste, tronditet nga deliret e pasojat e revolucionit kulturor në këtë vend, por ai e përjashton në mënyrë kategorike që Shqipëria, tashmë e mbetur pa asnjë aleat të fuqishëm, të rikthehet drejt Bashkimit Sovjetik. Mirëpo, a mund zhvillohet *normalisht* socializmi në Shqipëri pa mbështetjen e një fuqie të jashtme? Hipotezën e vazhdimësisë së shoqërisë socialiste shqiptare, të ndërtuar me “forcat tona”, shkrimtari Ismail Kadare rreket ta provojë te romanet *Dimri i madh* dhe *Koncert në fund të dimrit*, me anë të tablosë së jetës së përditshme në kryeqytetin shqiptar dhe të shenjave të “zvetënimit” të socializmit që personazhet shqiptare dallojnë në Moskë e Pekin. Për mendimin tonë, kjo është një strategji logjike dhe të dy romanet shërbejnë si një vitrinë e socializmit shqiptar, pavarësisht faktit nëse vitrina letrare pasqyron realitetin e kohës. Regjimit komunist shqiptar i nevojitej që të tregonte se, në kushtet kur kampi socialist ishte politikisht i përçarë, vendi ynë ishte në rrugën e duhur, sepse shoqëria socialiste, me pronë kolektive dhe prodhim e konsum të planifikuar, funksiononte dhe dobia e saj ishte bërë e prekshme për popullin. Prandaj, në romanet *Dimri i madh* dhe *Koncert në fund të dimrit*, kemi si përmasën epike të përballjes politike me revizionizmin, po ashtu dhe rrjedhën “realiste” të jetës së përditshme qytetare në socializëm, me njerëzit e zakonshëm që kanë gëzimet, shpresat, pritshmëritë e tyre, edhe gjatë periudhave të pazakonta historike nëpër të cilat kalon vendi.

Në këtë artikull do të përqendrohem pikërisht te tabloja e jetës kryeqytetase të të dy romanet Kadarese, për të hulumtuar sesi ngjarjet e mëdha politike perceptohen si mbarim i rrugës së

deritanishme të Shqipërisë si pjesë e kampit socialist, pas së cilës personazhet përpiqen të shquajnë kthesa në drejtime të tjera, apo prapakthesa drejt stacioneve të mëparshme. Të dy romanet analizohen bashkarisht, jo vetëm sepse autori i ka konceptuar si një diptik, me disa personazhe që shfaqen kronologjikisht në të dy romanet, por edhe ngaqë ata rrëfejnë dy ndarje të Shqipërisë socialiste nga dy fuqi të mëdha socialiste dhe kanë në qendër jetën urbane të pjesëtarëve të shtresës së intelektualëve e burokratëve. Kjo shtresë ishte krijuar nga ndryshimet politike e shoqërore që solli sistemi socialist në Shqipëri, kryesisht industrializimi, urbanizimi dhe rritja e nivelit të arsimit. Regjimi kishte një marrëdhënie ambivalente me këtë shtresë, sepse ndërsa zyrtarët, teknikët dhe artistët ishin të nevojshëm për ndërtimin e bazës materiale të socializmit dhe për “farkëtimin” e Njeriut të Ri, ata mund të ktheheshin në një klasë shoqërore të privilegjuar, në raport me punëtorët dhe fshatarët. Zyrtarët dhe intelektualët merrnin pjesë në administrimin e shtetit, të shoqërisë e kulturës dhe shumë prej tyre ishin njëkohësisht edhe komunistë, por, në krahun tjetër, ata mund të sfidonin monopolin e pushtetit politik që kishte udhëheqja e Partisë së Punës. Nëse socializmi shqiptar do të kalbëzohej nga brenda, shkak do të ishte “tradhtia e intelektualëve”, siç kishte ndodhur me shtetet e kampit socialist.⁵ Dy romanet e Kadaresë kanë në qendër jetën shoqërore të shtresës intelektuale-burokratike dhe çështja e besnikërisë politike të saj është një nga temat e tyre.

Kur shkruajmë për tablo të jetës së përditshme në romane e

⁵ Shih Peter R. Prifti, *Socialist Albania since 1944: Domestic and Foreign Developments [Shqipëria socialiste që nga viti 1944: Zhvillime brenda dhe jashtë vendit]*, Cambridge (MA): The MIT Press, 1978, f. 167-194.

kemi të qartë se në letërsi është e pamundur të ketë pasqyrim të përpiktë të realitetit. Përshkrimi i përimitë i hollësive të jetës në letërsi nuk synohet as nga metoda e realizmit socialist dhe kritika e kohës, që një qasje të tillë e përbuzte si “natyralizëm”. Përkundrazi, romani i realizmit socialist synonte të ishte një alegori e marksizëm-leninizmit, si forcë vepruese në histori. Në qendër të romanit të realizmit socialist vihej një njeri i zakonshëm, heroi pozitiv, i cili përjeton ngjarje të jashtëzakonshme që atij i shërbejnë si rituale kalimi nga vetvetshmëria te ndërgjegjësimi klasor, si dhe nga jeta private te ajo kolektive. Gjatë këtyre ritualeve, heroi pozitiv frymëzohet dhe udhëzohet nga një ose disa figura “atërore”, që janë më të moshuara, më të formuara politikisht dhe që gëzojnë autoritet.⁶ Te romani *Dimri i madh*, riti i kalimit për Besnik Strugën është genia e tij dëshmitar në përballjen e PPSH-së me “revizionizmin hrushovian” gjatë mbledhjes në Moskë të partive komuniste nga e gjithë bota. “Etërit” janë Enver Hoxha dhe shkrimtari Skënder Bermema. Prej fjalëve dhe sjelljes së udhëheqësit komunist të Shqipërisë në Moskë dhe prej këshillave dhe mbështjetjes morale që i jep Skënderi në Tiranë, Besniku bëhet më i ndërgjegjshëm për rolin e vet si komunist dhe si pjesëtar i brezit të dytë që do të marrë stafetën e revolucionit. Pas përjetimeve në Moskë, perspektiva e një jetese të rehatshme e “mikroborgjeze” nuk e mbush më shpirtërisht Besnikun dhe, për pasojë, Zana largohet prej tij. Romani i realizmit socialist synon t’u tregojë lexuesve se historia po bëhet para syve të tyre, se heroikja gjendet te

⁶ Katerina Clark, *The Soviet Novel: History as Ritual* [Romani sovjetik: Historia si ritual], Chicago: The University of Chicago Press, 1981, f. 119-120.

përditshmëria e ndërtimit të socializmit dhe, në këtë mënyrë, t’i motivojë ata për t’u përfshirë me entuziazëm në përpjekjen kolektive. Prandaj, tabloja e jetës së përditshme të personazheve që ndeshim te të dy romanet nuk duhet marrë si përshkrim sociologjik, sepse ajo shërben si tipizim i modernitetit socialist, të bërë të mundur, ose që gjithsesi do të duhej bërë i mundur, nga zbatimi i ideologjisë marksiste-leniniste (staliniste).

Në këtë pikë, ndonjë lexues i artikullit mund të kundërshtojë trajtimin tonë “sipërfaqësor” të dy romaneve të Kadaresë si vitrinë (propagandë) e jetës së përditshme moderne në Shqipërinë socialiste. Studiues të letërsisë së Kadaresë kanë vënë në dukje se, ndonëse romani *Dimri i madh* konsiderohej si një vepër madhore e realizmit socialist, sepse ai pasqyronte demaskimin nga ana e PPSH-së të revizionistëve sovjetikë,⁷ aq sa vetë Enver Hoxha e mbrojti prej kritikave pasi romani u botua,⁸ prapëseprapë autori përfshiu në të elementë subversivë që binin ndesh me metodën zyrtare dhe që do të mundësonin edhe leximin e tij si një vepër disidente, estetikisht dhe ideologjikisht.⁹ Prej këtij leximi alternativ, përshkrimi që autori i bën jetës moderne të Tiranës në fillimin e viteve 1960, del se është një “haraç” i domosdoshëm për botimin e librit.¹⁰ Po kjo mund të thuhet edhe për skenat e jetës së përditshme te *Koncerti*, i cili fillimisht nuk

⁷ Shih p.sh. Dalan Shaplllo, *Vështrime teorike-letrare*, Tiranë: Naim Frashëri, 1978, f. 76.

⁸ Enver Hoxha, *Vepra, vëllimi 51: Maj 1973-qershor 1973*, Tiranë: 8 Nëntori, 1986, f. 71-77.

⁹ Jean-Paul Champseix, *Ismail Kadare: Një disidencë letrare*, Tiranë: Fan Noli, 2021, f. 112, 140-193; Met Dervishi, *Intertekstualja dhe disidentja te Dimri i vetmisë së madhe*, Tiranë: Saras, 2014.

¹⁰ Champseix, *Ismail Kadare: Një disidencë letrare*, f. 144-145.

u lejua të botohej, sepse nga partia u vlerësua si “thellësisht i gabuar ideologjikisht dhe i dobët artistikisht”.¹¹ Pavarësisht këtij interpretimi “të thellë” të dy romaneve, për trajtimin e temës sonë, atë të (mos)fundit të socializmit në Shqipëri, mendojmë se është thelbësor përqendrimi te tabloja (propaganduese) e jetesës komode, sado që kjo të mos përputhet me realitetin e viteve 1960-1970. Nëse socializmi nuk sjell për “masat punonjëse” ato përfitime të prekshme materiale që, sipas ideologjisë komuniste, në rendin borgjez janë të arritshme vetëm për një pjesë të vogël të popullit, atëherë pse punëtorët dhe fshatarët duhet ta mbrojnë socializmin dhe vijimin e revolucionit?

Vendosja e fjalës “borgjezi” në titull ka parasysht si kuptimin e hershëm të fjalës, që do të thoshte banor i një qyteti apo kështjelle, si kuptimin modern e marksist për borgjezinë si “klasa sunduese” në shoqërinë kapitaliste, së cilës në shoqërinë socialiste ia zë vendin klasa punëtore. Skenat mbizotëruese të dy romanet e Kadaresë janë kryeqytetet e vendeve socialiste: Tirana, Moska dhe Pekini dhe personazhet e tij janë qytetarët e shtresave të ndryshme: shtetarë, intelektualë, burokratë dhe punëtorë, si dhe ish-tregtarë e ish-burokratë të klasave të përmbysura. Borgjezia e përmbysur paraqitet si “e zezë” në letërsinë dhe artet shqiptare të periudhës komuniste, ndërkohë ideologjia komuniste në Shqipëri pas vitit 1960 nisi të përpunonte tezën se në vendet “revizioniste” prej krerëve renegatë të partisë dhe shtresës burokratiko-intelektuale formohet një borgjezi e re që i jep fund socializmit dhe, duke mashtruar punëtorët, përgatit kushtet për

¹¹ Beqir Meta, Afrim Krasniqi dhe Hasan Bello, red., *Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit (dokumente arkivore)*, vëll. 4, 1997-1984, Tiranë: Emal, 2021, f. 339.

rikthimin në kapitalizëm (që në fakt do të ndodhte vërtet në vitin 1989, por me dorëzimin e pushtetit politik nga partitë komuniste).¹² Në një poezi të Kadaresë, këta thirren “pashallarët e kuq”, por më mirë do t’u rrinte etiketa e “borgjezisë së kuqe”, sepse “revizionizmi” nuk synon kthimin në rendin feudal. Ndërsa nga këndvështrimi i pjesëtarëve të “klasave të përmbysura”, komunistët në krye të shtetit ishin tashmë një klasë sunduese që kontrollonte politikën, ekonominë dhe jetën shoqërore të vendit, në një shkallë të atillë që nuk kishte të krahasuar me borgjezinë e shteteve kapitaliste.

II. Rrëfimi i jetesës socialiste në Tiranën e viteve 1960-1970

Romanet *Dimri i Madh* dhe *Koncert në fund të dimrit* përmbajnë përshkrime të jetës së përditshme të tri familjeve që i përkasin shtresës burokratiko-intelektuale të regjimit komunist dhe që janë të ndërlidhura midis tyre: familja e Besnik Strugës, gazetar dhe pjesëmarrës në delegacionin e nivelit të lartë të Shqipërisë në mbledhjen e partive komuniste të Moskës; ajo e shkrimtarit Skënder Bermema, gruaja e të cilit është tezja e Zanës, së fejuarës së Besnikut; dhe ajo e dy motrave Krasniqi: Ana, punonjëse në Institutin e Vaksinimit, martohet me Besnik Strugën pasi prishet fejesa e tij me Zanën; motra e dytë, Silva, arkeologe dhe më pas nëpunëse në Ministrinë e Ndërtimit, është

¹² Sipas këtij këndvështrimi, lëvizja e sindikatave të punëtorëve në Poloninë e fillimit të viteve 1980 do të cilësohej si “kundërrevolucion brenda kundërrevolucionit”. Shih Institutin e Studimeve Marksiste-Leniniste, *Historia e PPSH*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1983, f. 630; Spiro Dede, *Kundërrevolucion në kundërrevolucion*, Tiranë: 8 Nëntori, 1983.

gruaja e Gjergj Dibrës, korrierit diplomatik që i dorëzon udhëheqjes komuniste kineze letrën denoncuese të Enver Hoxhës. Para martesës me Besnikun, Ana ka pasur një pëlqim romantik për Skënder Bermemën dhe vite më vonë Silva i drejtohet Skënderit, që ky përmes njohjeve të veta ta ndihmojë të marrë të dhëna për hetimin e hapur ndaj vëllait të saj. Personazhet dytësorë të romaneve i përkasin ose kanë lidhje shoqërore me këto familje. Kështu, kunata e Skënder Bermemës është Liria, nëna e Zanës dhe gruaja e zv/ministrit Kristaq; Arben Struga, vëllai i Besnikut, është shok me Maks Bermemën, kushëririn e Skënderit; motra e Maksit, Diana Bermema është shoqe me Zanën etj.

Të tria familjet janë të lidhura ngushtë me pushtetin popullor. Në krye vijjnë Bermemat, me dy zëvendësministra, një ambasador, e disa sekretarë partie në rrethe. Babai i Zanës, Kristaqi, është zëvendësministër, Gjergj Dibra dhe Saimir Krasniqi, ky i fundit vëllai i motrave Krasniqi, janë anëtarë partie, nëna e Maks dhe Diana Bermemës është aktiviste e organizatës së gruas, ndërsa babai i tyre i ndjerë ka qenë anëtar i komitetit qendror të partisë dhe ministër i qeverisë së parë komuniste. Besnik Struga dhe shoku i tij Viktor Hila janë kandidatë partie dhe rrugës për t'u bërë anëtarë. Pushteti dhe ngritja shoqërore e këtyre familjeve burojnë nga gryka e pushkës: Bermamat kanë dhënë dëshmorë gjatë luftës dhe një tjetër ushtarak nga fisi i tyre ka rënë dëshmor gjatë viteve të socializmit, duke pilotuar një avion reaktiv. Motrat Krasniqi kanë një teze dëshmore të luftës. Nëna e Maks dhe Diana Bermemës, Kristaqi dhe Xhemal Struga, babai i Besnikut, kanë qenë partizanë. Saimir Krasniqi është oficer tankist.

Edhe pse regjimi socialist është i ri, “më i ri se vetë rinia” thotë me vete personazhi Enver Hoxha në vitin 1961,¹³ po krijohen familjet me tradita komuniste që do të jenë shtyllat mbajtëse të tij, sikurse janë për rendin borgjez familjet e mëdha tradicionale. Nëse në këto të fundit dramat shkaktohen nga trashëgimitë, ndarjet e pronave e falimentimet, në modernitetin socialist pa pronë private, dramat e familjeve komuniste shkaktohen nga furtunat politike, prej të cilave ishte rreziku që të “mbinte ndonjë njollë e vogël ndër fotografi albumesh”,¹⁴ që mbulonte fytyrën e familjarit të përjashtuar nga partia. Nga aspekti sociologjik, duhet mbajtur parasysht se në gati gjysmë shekulli Shqipëri socialiste kishte tri breza të shtresës burokratiko-intelektuale. I pari përbëhej nga zyrtarë e specialistë të fushave të ndryshme që ishin formuar përpara socializmit, kryesisht në universitetet e Evropës Perëndimore. Një pjesë e tyre u persekutua, ndërsa një pjesë u përdor nga regjimi komunist për aq kohë sa studentët prej familjeve që përkrahnin regjimin ishin duke u formuar në shkollat e Bashkimit Sovjetik, të vendeve të tjera të kampit socialist dhe në shkollat brenda vendit. Specialistët e formuar nga mesi i viteve 1940 deri në fund të viteve 1950 përbëjnë brezin e dytë të shtresës burokratike-intelektuale. Me prejardhje nga borgjezia e vogël qytetare apo nga familje fshatare, ata përfituan më shumë nga lëvizshmëria shoqërore e shkaktuar nga sistemi socialist. Ata do të drejtonin ndërtimin e shumë veprave industriale dhe do të banonin në qendrat e qyteteve, krahas drejtuesve partiakë. Janë ata që mbizotërojnë ndër personazhet pozitivë të dy romanet e

¹³ Kadare, *Vepra letrare* 7, f. 431.

¹⁴ Kadare, *Vepra letrare* 7, f. 287.

Kadaresë. Besnik Struga ka kryer studimet në Moskë, ai flet dhe rusishten e vjetër, veç asaj moderne.

Pas ndërprerjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, udhëheqësit komunistë spastruan edhe brezin e dytë prej atyre elementëve që i konsideronin jobesnikë. Fushatat kundër liberalizimit dhe kundër burokratizimit të viteve 1960-1970 synonin që të mbanin nën kontrollin e partisë këtë brez, i cili edhe pse ishte formuar në socializëm mund të ishte i pakënaqur me vijimin e linjës staliniste të regjimit dhe me shkëputjen nga kampi socialist. “Armiqtë” në mesin e tyre ishin më të vështirë për t’u pikasur, sepse ata vinin nga familje të lidhura me lëvizjen partizane ose nga familje fshatare apo të vegjëlisë qytetare, ndërsa specialistët e mbijetuar të brezit të parë identifikoheshin më lehtë dhe mbaheshin nën mbikëqyerje të vazhdueshme për shkak të së kaluarës së tyre “borgjeze”. Spastrimet dhe goditjet kundër intelektualëve në arte dhe kulturë u përqendruan sidomos në vitet 1971-1973, në kuadër të së cilave funksionarët e lartë të partisë që ishin përgjegjës për politikën në arte dhe kulturë, Fadil Paçrami dhe Todi Lubonja, u përjashtuan nga partia dhe funksionet shtetërore dhe më vonë u dënuan me burgim. Ndërsa burokracia shtetërore u spastrua me rastin e goditjeve të grupeve armiqësore në ekonomi, industrinë e naftës, e sidomos në ushtri, ku mjaft ushtarakë të lartë kishin studiuar në Bashkimin Sovjetik. Në vitet 1970 në postet kyçe të partisë e të shtetit u emëruan persona të thirrur nga klasa punëtore, pa merita vetjake në luftën partizane dhe shpeshherë pa arsimin përkatës. Madje, midis anëtarëve të rinj të Byrosë Politike dhe të ministrave, nuk kishte asnjë nga katedrat universitare dhe akademike; ky ishte një mesazh i qartë i mosbesimit të partisë ndaj brezit të dytë të

intelektualëve.¹⁵ Në këtë klimë të izolimit nga bota e jashtme, të “revolucionit kulturor” dhe të terrorit, u formua nga mesi i viteve 1960 e deri në fillim të viteve 1980 brezi i tretë i specialistëve, në pjesën dërrmuese në universitetin shtetëror dhe shkollat profesionale brenda vendit. Ai përbëhej kryesisht nga fëmijët e drejtuesve partiakë dhe të shtresës burokratiko-intelektuale, e cila, për shkak të kapitalit njerëzor dhe të njohjeve e kishte më të lehtë që ta riprodhonte vetveten me anë të arsimit, sesa e kishin fëmijët e familjeve punëtore dhe fshatare për t’u ngritur në shkallën shoqërore. Afërmendësh, konformizmi politik do të ishte më i madh te ky brez, por pikërisht atij i takoi që të merrte drejtimin politik dhe ekonomik të Shqipërisë pas rënies së komunizmit.

Përderisa dy romanet e Kadaresë trajtojnë ndarjen e Shqipërisë prej “supershteteve” socialiste, çështja e besnikërisë së shtresës burokratiko-intelektuale zë një vend qendror te ta. Kjo duket deri te zgjedhja e emrit Besnik për personazhin kryesor të *Dimrit të Madh*. Kadareja përmes psikologjisë dhe marrëdhënieve të këtyre personazheve me njëri-tjetrin duket sikur jep sigurinë se shtresa e tyre nuk ka se si ta braktisë Partinë dhe revolucionin shoqëror prej të cilit ajo vetë është ngritur. Edhe të rinjtë Arben Struga dhe Maks Bermema e quajnë idiotizëm një thënie të shokut të tyre se Shqipëria do të bëhet prapë një vend kapitalist. Shoku i tyre njëherë tjetër u kishte thënë se ekzistonte mundësia të forcoheshin lidhjet me Turqinë, me siguri fjalë të dëgjua nga i ati që frekuentonte një kafene ku mblidheshin

¹⁵ Beqir Meta, Marenglen Verli dhe Muhamet Jashari, red., *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, vëllimi 5*, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2023, f. 104.

myslimanë të vjetër.¹⁶ Vendosja në të njëjtin plan e kapitalizmit me Turqinë dhe islamit do të thotë se fundi i socializmit është po aq i mundur sa dhe ecja së prapthi e historisë së Shqipërisë.

Në përshkrimet e rutinës së personazheve të mësipërme dhe të disa të tjerëve të rrethit të tyre, shfaqet një tablo e jetës së përditshme në Tiranën e viteve 1960-1970. Kryeqyteti është një qytet modern me rrugë të ndriçuara, me vitrina që ekspozojnë mallra të shumëllojshme, që nga mobilieritë e enët e kuzhinës e deri te konfeksionet e bonboneritë. Ndërkohë që jepet lajmi për ndërprerjen e kredive nga shtetet socialiste, Zana shkon te salloni i modës, sepse ka dëgjuar se ka dalë në shitje një stof i bukur për pallto. Shtresa intelektuale-burokratike jeton në vilat që i janë shtetëzuar borgjezisë dhe në apartamente të bollshme të pallateve të ndërtruara në vitet e fundit, ku nuk mungojnë dushet, televizorët, frigoriferët, telefonat dhe magnetofonët me të cilët të rinjtë incizojnë këngët që u pëlqejnë. Zana dhe Besniku presin që pas martesës të pajisen me apartament më vete, njëri nga mijëra syresh që po ndërtohen, prandaj gjatë fejesës bëjnë plane për mobilimin e tij.¹⁷ Një darkë e zakonshme në familjen e zëvendësministër Kristaqit përmban ujë mineral, verë, taljatele, biftek, patate të skuqura, sallatë ruse, kremkaramel (gatuar nga Zana) dhe kafe. Edhe në darkën festive të ditëlindjes së vajzës së Silvës dhe të Gjergj Dibrës nuk mund të mungojë uji mineral. Para se të vijnë të ftuarit, Silva bën një dush të shpejtë për të hequr nga trupi erërat e gatimit.¹⁸ Afërmendsh, edhe pse kemi të

¹⁶ Kadare, *Vepra letrare* 7, f. 285, 322.

¹⁷ Po aty, f. 9-13, 43, 45-46, 55, 319.

¹⁸ Po aty, f. 21-22; Ismail Kadare, *Koncert në fund të dimrit*, Tiranë: Naim Frashëri, 1988, f. 5.

bëjmë me personazhe nga shtresa burokratike-intelektuale, këto të mira materiale e komoditete (p.sh. furnizimi i pandërprerë me ujë, dushet, televizorët e telefonat) nuk kanë se si t'i kenë vetëm ata, por edhe masat e gjera punëtore e fshatare që jetojnë në kryeqytet dhe nëpër rrethet e vendit. Këtë e mësojmë nga letra që një nënpunës i mesëm i dërgon Mao Ce Dunit, ku përmendet se niveli i jetesës në Shqipëri është së paku dhjetë herë më i lartë se në Kinë, se njerëzit në Shqipëri kanë apartamente të pajisura me kolltukë e dritare me perde, kanë dyqane ku shitet bukë e bardhë etj. “Jeta jonë,” thotë nëpunësi kinez, “është një mjerim në krahasim me atë të tyre”.¹⁹ E mësuar me jetesën e saj komode, Ana Krasniqi kur dëgjon për bllokadën e kampit sovjetik, thotë: “Vetëm kursim të mos ketë” dhe Silvës i kujtohen këto fjalë kur nis prishja e aleancës me Kinën.²⁰

Nëse do ta krahasojmë këtë panoramë letrare të modernitetit me Tiranën e viteve 1950-1980, sigurisht që mospërkimet me realitetin janë shumë të mëdha. Urbanizimi socialist i Tiranës nuk ndoqi një master-plan, por u realizua pjesë-pjesë, sipas projekteve industriale të regjimit dhe në varësi të mungesave kronike në materiale e burime njerëzore, sidomos pas ndarjeve nga Bashkimi Sovjetik e Kina. Me gjithë ndërtesat e reja, strehimi mbeti një problem i mprehtë për të gjithë periudhën socialiste, sepse as sistemi i pasaportizimit nuk arriti të frenonte dyndjen në Tiranë e qytete të tjera të atyre që me çdo kusht kërkonin të shpëtonin nga jetesa më e vështirë në fshat. Kështu, në Tiranë “beteja për hapësirë jetese, preku individët në të gjitha nivelet, nga zemra e aparatit të partisë deri te cepat e sallave të

¹⁹ Kadare, *Koncert në fund të dimrit*, f. 46, 50.

²⁰ Kadare, *Vepra letrare* 7, f. 368; Kadare, *Koncert në fund të dimrit*, f. 79.

fabrikave”.²¹ Ishte e zakonshme që bashkëshortët dhe fëmijët e tyre të jetonin në të njëjtën banesë me prindërit e burrit (më rrallë të gruas) dhe ndodhte që dy familje, me apo pa lidhje gjaku, të vendoseshin në të njëjtin apartament, sikurse kishte familje me fëmijë që jetonin për vite me radhë në një dhomë hoteli. Për të marrë autorizimin për një banesë të re, apo për një banesë më të madhe se ekzistuesja, duhej të prisje për vite me radhë. Në vitin 1959, pak para ndërprerjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik, për të cilën Kadareja shkruan në romanin *Dimri i madh*, sipas llogaritjes së sipërfaqes mesatare të banuar për frymë, në Shqipëri i binte që një dhomë e vetme të ndahej midis tre apo katër personave.²² Edhe ata që atëherë ishin me fat që të hynin në apartamente të reja, ankoheshin për hapësirat e pamjaftueshme, cilësinë e dobët të punimeve dhe për mungesën e shërbimeve të nevojshme në lagje, si p.sh. mospasjen e një vendgrumbullimi të mbeturinave.²³ Nga mesi i viteve 1980, për t’iu përgjigjur nevojave të ngutshme për strehim nisi ndërtimi i pallateve me “punë vullnetare”. Personit të pajisur me autorizim i duhej të bënte orë pune shtesë në pallatin që ndërtohej, për të pasur të drejtën e një apartamenti.

Edhe për pajisjet elektro-shtëpiake kërkohej një autorizim i veçantë, përveç kosos së secilës prej tyre (makinë larëse, frigorifer, televizor) që shkonte sa shuma e disa rrogave të një punëtori. Anëtarët e partisë, intelektualët dhe burokratët ishin më

²¹ Elidor Mëhilli, *From Stalin to Mao: Albania and the Socialist World* [Nga Stalini te Mao: Shqipëria dhe bota socialiste], Ithaca: Cornell University Press, 2017, f. 166.

²² Po aty, f. 180.

²³ Po aty, f. 181-182.

të privilegjuar sesa punëtorët dhe fshatarët për t'u pajisur me këto mallra, me anë të të cilave dëshmohej dhe prestigji shoqëror i zotëruesit. Funkionarët partiako-shtetërorë dhe intelektualët ishin më të predispozuar për të pasur lidhje telefonike në shtëpi, diçka kjo që lehtësonte dhe dendësonte komunikimin brenda tyre sesa me kategori të tjera shoqërore. Jetesa mesatare në Shqipëri mund të ishte më e lartë sesa ajo në Kinën e kohës, por gjithsesi mungesat ishin të shumta. Në vitet e fundit të regjimit, ushqimet bazë bliheshin në sasi të kufizuara, të përcaktuara në bazë të numrit të pjesëtarëve në familje. Buka e bardhë shpërndahej rregullisht në kryeqytet e në qytetet kryesore, ndërsa për pjesën tjetër të vendit kishte vetëm bukë të zezë apo misri.

Mirëpo, po të marrim për bazë dy romanet e Kadaresë, jeta shoqërore në sistemin socialist është bërë e bukur dhe e gëzueshme. Kafenetë e kinematë janë plot dhe nëpër klube organizohen mbrëmje vallëzimi gjatë muajit të miqësisë shqiptaro-sovjetike. Emancipimi i socializmit bie në sy sidomos në sjelljen e vajzave dhe grave. Siç e vëren nëpunësi kinez në letrën për Maon, në dyqane shiten të kuq buzësh, vajzat dhe gratë e reja hedhin parfum, ato ulen nëpër kafene për të pirë kafe e konjak e lexojnë romane.²⁴ Shumicës së vajzave të fejuara, ua lënë rrogën ta përdorin për veten, gjë që tregon se familjet ia dalin mbanë pa të ardhurat e vajzave të tyre.

Erotizmi është i pranishëm në jetën e çifteve. Të fejuarit Besnik dhe Zana kalojnë pushimet verore së bashku dhe nuk u pritët sa të martohen, aq sa Liria dyshon për ndonjë shtatzani të Zanës. Besniku ëndërron netët që do të kalojë me gruan e tij të

²⁴ Kadare, *Koncert në fund të dimrit*, f. 46.

bukur dhe Zana miklohet nga fjalët që i hedhin djemtë në rrugë. Ana Krasniqi mendon se shtatzania do t'ia prishë linjat e trupit të saj të përsosur dhe, siç duket e papërmbushur nga martesja, ëndërron për dashuri të mundshme me burra të tjerë. Ajo ka një lidhje platonike me shkrimtarin Skënder Bermema, nuk e duron dot xhelozinë e burrit të vet dhe pas ndarjes me të, martohet me Besnikun, i cili tashmë është ndarë nga Zana. Silva ka dhe ajo historitë e saj të shkurtra të dashurisë para martesës me Gjergjin. Edhe pasi është bërë nënë, ajo kujdeset për linjat trupore dhe paraqitjen e jashtme.

Edhe pse dashuritë e personazheve pozitive janë të ndryshme nga jeta mondane e dikurshme, që e kujtojnë personazhet e deklasuar të romaneve, prapëseprapë në ndonjë rast nxjerr kryet meskiniteti. Zana hidhërohet që Besniku nuk i ka sjellë dhuratë nga Moska. Ajo duket që është mësuar me sende të tilla sqime, sepse ka hedhur një deodorant që i ati ia ka sjellë nga jashtë shtetit. Edhe pëlqimi i saj për aeroportet me sa duket buron ngaqë ato i sheh si dyer që komunikojnë me botën jashtë. Ndërsa drama e brendshme e Besnikut ka të bëjë me mosmarrëveshjen e madhe të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik dhe shtetet e tjera socialiste të Evropës, Zana e sheh veten si “femër me dramë” prej mosmarrëveshjes që ka me të fejuarin.²⁵ Llastimi dhe mendjelehtësia e Zanës vijnë pikërisht nga jetesa komode dhe e bukur që i ka siguruar asaj sistemi socialist dhe pushteti i babait. Edhe pse Kristaqi dikur ka qenë partizan, ai mund të ketë rënë pre e vetëkënaqjes burokratike dhe nuk i kushton kujdes ndërgjegjësimit politik të vajzës së tij. Rënia e Zanës në krahët e

²⁵ Kadare, *Vepra letrare* 7, f. 19, 226-227, 320.

Markut, edhe pse një incident i veçuar i shkaktuar nga ftohja e saj me Besnikun, duket se shërben si paralajmërim se nga indiferentizmi politik mund të rrëshqasësh në pozita armiqësore. Po kështu, edhe burokratët kur shkëputen prej klasës punëtore kthehen në një borgjezi të veshur me mantel të kuq.

Për të mos lënë përshtypjen se liria personale i ngjan asaj në botën kapitaliste, autori e shpreh të vërtetën se marrëdhëniet e çifteve intelektuale monitorohen nga familjet dhe organizatat partiake. Sado të shpenguar të jenë me njëri-tjetrin të dashuruarit apo bashkëshortët, ata nuk mund t'i pengojnë familjet, kolektivat e punës apo organizatat partiake t'u përzihen në marrëdhëniet e çiftit. Ndërsa kontrolli zakonor mbi dashurinë e të rinjve nuk miratohet nga fryma e shoqërisë së re, e njëjta gjë nuk mund të thuhet për kontrollin politik që ushtrojnë organizatat e partisë. Madje prindërit që ndjehen të çarmatosur prej armëve të moralit tradicional për të komanduar jetën e të rinjve, nuk ngurojnë që për të njëjtin qëllim t'i drejtohen organizatave të partisë. Kur Besniku pas ardhjes nga Moska mbyllet në vetvete dhe nuk vijon përgatitjet e martesës me Zanën, Liria vendos të ankohet te vendi i punës së Besnikut. Organizata bazë e redaksisë së gazetës e pyet Besnikun për marrëdhëniet me të fejuarën dhe ia pezullon anëtarësimin në parti derisa ai të japë sqarime për këtë çështje.

Gjithashtu, çifti mund të shpërfillë thashethemet, shpifjet, letrat anonime për çështje morali, gruaja mund ta ndajë burrin e sëmurë nga xhelozia, tipave meskinë e tinzarë si Raqi mund t'ua tregosh vendin kur përzihen në çështjet e tua private, por nuk mund të shpërfillen tabutë politike, sepse një vendim i gabuar në jetën private ndikon në mënyrë rrënjësore fatin tënd dhe atë të familjes. Sa më lart në hierarkinë e pushtetit, aq më shumë

kontroll ushtrohet mbi dashurinë dhe seksin. Përzierja familjare me të deklasuarit duhet ndaluar më rreptësi, sepse përndryshe dobësohet lufta e klasave. Bermemat shqetësohen shumë kur një vajzë e fisit kërkon të fejojë me një djalë nga një familje e deklasuar dhe ata përpiqen që t'ia kthejnë mendjen, sepse kjo pakujdesi e së resë i rrezikon të gjithë. Zana dhe Mark Kryekurti e dinë se incidenti i marrëdhënies së tyre seksuale nuk duhet të merret vesh kurrsesi prej familjeve të tyre.

Për sa i përket jetës publike, organet e shtypit janë në pronësi të institucioneve shtetërore dhe të organizatave të partisë, por prapëseprapë gazetari ka lirinë të kritikojë një ministër, duke mos u druar as prej faktit se gruaja e këtij merret me propagandën në parti. Ministri detyrohet të vijë vetë në redaksi për t'u ballafaquar me të dhënat e mbledhura nga gazetari. Ky i fundit ka besim se organizata bazë ose komiteti qendror i partisë do t'i japë të drejtë atij dhe jo ministrit.²⁶ Po kështu, përkthyesit shqiptarë mund të flasin shpengueshëm për shprehjet që Hrushovi ka përdorur gjatë vizitës së tij në Shqipëri, pa u frikësuar se mund të akuzohen se përgojnë kreun e partisë së Bashkimit Sovjetik; përkundrazi ky episod tregon që nuk ekziston kulti i individit në shoqërinë socialiste.²⁷ Vetëm të deklasuarit u servilosen funksionarëve të shtetit, prej frikës që nuk u ndahet.

Besimi te partia është i përgjithshëm: punëtorë e intelektualë ngrehin pandehma për atë që po ndodh me Bashkimin Sovjetik dhe Kinën, por presin se çfarë do t'u komunikojë partia me anë të organizatave bazë dhe shtypit. Atyre u duket normale që shtypi në vend vonon ta paraqesë të vërtetën e mbledhjes së Moskës,

²⁶ Po aty, f. 28-33.

²⁷ Po aty, f. 91-92.

apo që e njofton përçiptas vizitën e presidentit të SHBA-së në Kinë. Ata nuk dyshojnë për asnjë çast se partia nuk thotë të vërtetën, vetëm se asaj i duhet të gjejë kohën e përshtatshme për ta thënë atë. Kur në shtyp e televizion nisin sulmet e ashpra të partisë ndaj “revizionistëve” dhe nisin mbledhjet informuese nëpër vendet e punës, punëtorët menjëherë shprehin përkrahjen për partinë, sepse ajo thotë hapur mendimet që ata vetë kishin kohë që i bluanin në kokë apo i bisedonin me njëri-tjetrin. Kadareja kontrollin total të partisë mbi jetën publike (dhe ndërhyrjen e saj në jetët private të shtetasve) e paraqet si vetëdisiplinim e solidaritet të popullit në situatën revolucionare. Besnikut ruajtja e sekretit për përplasjen e madhe në Moskë i kushton prishjen e fejesës me Zanën, por ai nuk mendon se ka vepruar gabim, sepse detyra e tij si qytetar i republikës dhe si komunist qëndron mbi jetën e tij private. Mirëpo, ai është po aq i gatshëm të mbrojë jetën e tij private prej rrëmimit të padrejtë të ndonjë anëtari të organizatës bazë në marrëdhënien e tij me Zanën. Edhe pse anëtarësimi i tij në parti pezullohet përkohësisht, në fund organizata bazë i jep të drejtë Besnikut, duke e pranuar si anëtar partie.

Në fund të *Koncertit*, personazhi Enver Hoxha paraqitet duke përsiatur për brezin e dytë të revolucionit, gati dyzet vjet pas mbarimit të luftës. Bijtë apo nipërit e brezit që bëri luftën “bashkë me stafetën po merrnin mbi supet e njoma tërë barrën e sakrificave”.²⁸ Tani është koha që ai vetë të lerë skenën.

²⁸ Kadare, *Koncert në fund të dimrit*, f. 671

III. Të deklasuarit

Jetën e përditshme në socializëm e përshkon lufta e klasave, e cila ka nisur gjatë luftës çlirimtare: Xhemal Struga, i ati i Besnikut, është një nga partizanët që hedhin në erë mauzoleumin e nënës mbretëreshë pas çlirimit të Tiranës,²⁹ një akt ky që mund të merret si një shpallje simbolike e luftës kundër klasave sunduese të regjimit të vjetër. Biopolitika e regjimit komunist nxit përparimin shoqëror të familjeve që vijnë nga klasat punëtore e fshatare dhe bllokun përparimin shoqëror të familjeve që vijnë nga borgjezia e dikurshme ose nga ish-pronarët e tokave në fshat. Shoqëria është e ndarë në dy kasta që thuajse nuk takohen me njëra-tjetrën dhe jetojnë në botë paralele (në galaktika të ndryshme, mendon Silva Krasniqi).³⁰ Të deklasuarit, që janë shpronësuar dhe janë përjashtuar nga funksionet e rëndësishme shtetërore e shoqërore, u ngjajnë “të paprekshmëve” në sistemin indian të kastave: kontakti i të tjerëve me ta është tejet i kufizuar, kryesisht për ndonjë shërbim utilitar, si p.sh. mësimi i gjuhëve të huaja, apo qepja e rrobave: “Gjithë dimrin ata vinin rresht për të porositur pulovra, me një si tallje të përhershme në sy, sikur të thoshin: për rroba banje e pulovra jeni të mirë ju borgjezët.”³¹ Kjo e dhënë në roman është një pohim tjetër se jeta në socializëm është bërë e gëzueshme për pjesën më të madhe dhe “të shëndoshë” të popullit, edhe nëse nuk preceptohet si e tillë prej “të prekurve”: rrobat e banjës si simbol i jetës së ngeshme të klasës borgjeze (Hava Fortuzi kishte bërë

²⁹ Kadare, *Vepra letrare* 7, f. 55-56.

³⁰ Kadare, *Koncert në fund të dimrit*, f. 261.

³¹ Kadare, *Vepra letrare* 7, f. 25.

plazh për çdo verë, deri në vitin 1945 kur i shtetëzohet vila familjare në bregdet), tani i porosisin dhe të tjerët.

Për biopolitikën komuniste, kriteri klasor vjen i pari dhe pas tij vjen qëndrimi i familjeve dhe i personave gjatë luftës. Familja Kryekurti favorizohet krahasuar me familje të tjera borgjeze, sepse ishin kujdesur për një partizan të plagosur rëndë gjatë çlirimit të Tiranës. Për pasojë, Kryekurtët lejohen të banojnë në katin përdhes të vilës së tyre (në katin e sipërm banon familja e Kristaqit), ku ndoshta më parë kanë jetuar shërbëtorët e tyre, dhe më vonë Mark Kryekurti lejohet të kryejë studimet e larta për muzikë e punësohet në orkestrën e operas. Nën regjimin komunist, vërtetimi për strehimin e partizanit të plagosur ka vlerë të madhe, gati po aq sa kishin titujt e pronësisë të pronave gjatë regjimit të mëparshëm. Në saje të vërtetimit të shkruar me laps nga një komandant partizan, ata tani mund të shënojnë në fund të autobiografive fjalët: “Familja jonë, megjithëse i përkiste klasës së borgjezisë së madhe dhe ka shfrytëzuar masat e popullit, ka ndihmuar Luftën Nacionalçlirimtare.”³²

Në dy romanet e Kadaresë, të dekluarit përfaqësohen nga familja Kryekurti – plaka Nurihan me të birin Mark dhe vajzën Emili – dhe nga ish-borgjezë që i vizitojnë: çifti Ekrem dhe Hava Fortuzi, Musabelliu, Llukë Alarupi e ndonjë tjetër. Ata jetojnë në botën e vet, martohen me njëri-tjetrin, kujtojnë të kaluarën, vëzhgojnë çfarë ndodh në “botën tjetër” (në katin e sipërm në rastin e Kryekurtëve), dëgjojnë lajmet në radiot e huaja, duke shpresuar që fati i tyre të ndërrojë. Në kuadër të orientalizmit shqiptar gjatë periudhës komuniste, këta personazhe paraqiten të

³² Po aty, f. 299.

orientalizuar, sepse janë të kapur fuqishëm pas së djeshmes, ndërkohë që pjesa tjetër e shoqërisë shqiptare marshon përpara në rrugën e modernitetit socialist. Borgjezia e dikurshme ka ndërruar vendet me shtresën burokratiko-intelektuale socialiste, sepse është kjo e fundit që në dy romanet paraqitet si më e emancipuar dhe bartëse e një morali të ri.³³ Për dallim prej botës së re socialiste, mbi botën e të deklasuarve, mbushur me nostalgji për të kaluarën dhe frikë prej së ardhmes, qëndron një “tis vjetërsie”.³⁴ Sikundër Orienti në shkrimet e orientalistëve përëndimorë, edhe ish-borgjezët shqiptarë karakterizohen nga irracionaliteti, besëtytënia (p.sh. falli me filxhan ose me letra bixhozi), pesimizmi, dhe pasiviteti.³⁵ Edhe pse një i deklasuar anonim ka dëshirën të hakmerret dhe ka krijuar në kokën e tij imazhet se si do t’i masakrojë dhe do t’i tërheqë zvarrë komunistët në sheshet e rrugët e Tiranës kur të plasë kundërrevolucioni,³⁶ personazhet e tjerë janë aq të frikësuar dhe mefshët, saqë Zanës Kryekurtët i duken të urtë, të parrezikshëm deri qesharakë, madje edhe atëherë kur Besniku i tregon asaj tmerret që kjo familje dikur u ka shkaktuar fshatarëve.³⁷ Ndërsa në romane të tjerë të periudhës komuniste, ish-borgjezët, ish-

³³ Shih Enis Sulstarova, *Arratisje nga Lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*, Tiranë: Pika pa sipërfaqe, 2019, f. 202-206.

³⁴ Kadare, *Koncert në fund të dimrit*, f. 254.

³⁵ Krs. Rasa Balockaite, “Bourgeoisie as Internal Orient in the Soviet Lithuanian Literature: *Roses are Red* by A. Biekaukas, 1959” [“Borgjezia dhe Orienti i brendshëm in letërsinë lituaneze sovjetike: *Trëndafilat janë të kuq* nga A. Biekaukas, 1959”], *Journal of Baltic Studies* [Revista e studimeve baltike] vëll. 47, nr. 1, 2016, f. 77-91.

³⁶ Kadare, *Vepra letrare* 7, f. 384-386.

³⁷ Po aty, f. 34-35.

bejlerët dhe ish-zyrtarët e regjimeve zogiste e fashiste vihen në shërbim të agjenturave të huaja dhe sabotojnë ekonominë socialiste,³⁸ në dy romanet e Kadaresë, përfaqësuesit e “borgjezisë së zezë” nuk bëjnë asgjë tjetër veçse mblidhen me njëri-tjetrin për të diskutuar shenjat që tregojnë fundet e aleancave të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik dhe Kinën. Madje Marku ka hequr dorë edhe prej ëndërrimeve për kundërrevolucionin, sepse nuk e përfytyron dot veten me armë në dorë nëpër rrugët e Tiranës, duke kërkuar për të vrarë në vend komunistë dhe funksionarë të regjimit: “Jo, ai me siguri nuk ishte i aftë për këtë gjë. Në rast turbullirash ai do të strukej prapë në bodrum, duke pritur trokitjen e fatit të verbër. Siç dukej, shpirtërisht ai ishte i deklasuar”.³⁹

Ndërkohë që partia ende nuk i ka informuar komunistët e organizatave bazë dhe as popullin për mbledhjen e Moskës, “të deklasuarit” i kanë kapur me antenat e tyre gjithnjë të ngritura sinjalet e mosmarrëveshjes midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik. Ata nisin të shpresojnë për fundin e socializmit. Në mënyrë paradoksale, shpresat iu vijnë nga Bashkimi Sovjetik, pikërisht prej andej nga u ka ardhur furtuna e komunizmit. Plaka Nurihan në faqet e para të romanit thotë me vete: “Erë e marrë që na përmbyste të gjithë... Siberi. Shkretëtirë e Gobit. Shkretëtirë e Nurihanit” dhe i lutet Zotit që ta marrë sa më shpejt, por aty nga mesi i romanit nis të lutet si më poshtë:

“Perëndi, që më solle gjer në këtë ditë, lërmë edhe këtë dimër mbi tokë, sa të shikoj fundin e tyre. Lërmë. Shtëpia që

³⁸ Enis Sulstarova, “Lufta e klasave përmes realizmit socialist: Rasti i romaneve e novelave me agjenturë”, *Politikja*, 2/2017, f. 109-135.

³⁹ Kadare, *Vepra letrare* 7, f. 301.

ishite bërë si gërmadhë po ngjallet, njerëzve po u lëviz gjaku, po u kthehen fjalët, nervat. Nga filloi kjo grindje e bekuar, kjo erë që po na ngjall të gjithë. Larg. Shkretëtirë e Siberisë. Shkretëtirë e Gobit. Oaz i Nurihanit.”⁴⁰

Të mësuar ta shohin Shqipërinë nën varësinë e shteteve të tjera më të fuqishme, përfaqësuesve të klasave të përmbysura nuk u besohet se socializmi do të mund të mbahet “me forcat tona”, prandaj logjikojnë se shkëputja e Shqipërisë nga kampi socialist do të pasohet nga kthesa drejt Perëndimit. Sipas Ekrem Fortuzit: “Tani, duan s’duan, do të zgjatin dorën nga Perëndimi, se Lindja ua preu bukën”.⁴¹ Por atyre u venitet shpresa kur dëgjojnë në radiot perëndimore se Shqipëria do të bëhet një Kinë e vogël në Evropë. Ekrem Fortuzit, që gjatë viteve të burgimit ka mësuar rusishten dhe përkthen tekste për institucionet shtetërore tani do t’i duhet të mësojë kinezçen për të mbijetuar.⁴² Koha bën punën e vet dhe kur vjen grindja me Kinën, ish-borgjezët duken më të demoralizuar. Komunizmi ka hyrë në dekadën e katërt, regjimi i vjetër u duket aq i largët, saqë edhe po t’u afrohet alternativa perëndimore, ata frikësohen se nuk do të jenë në gjendje ta përballojnë. Ekrem Fortuzi kapet fort pas shpresës se ndarja me Kinën nuk do të jetë përfundimtare, jo vetëm sepse nuk do që t’i shkojë dëm kinezçja e mësuar me shumë mundim, por edhe sepse...

“...prej kinezëve vinte shpëtimi. S’ishite vetëm afrimi i tyre me amerikanët, që kishte ndodhur kohët e fundit dhe që

⁴⁰ Po aty, f. 26, 309-310.

⁴¹ Po aty, f. 407.

⁴² Po aty, f. 526-527.

u kishte hapur sytë përfundimisht. Shumë kohë para afrimit me Amerikën kishin dëgjuar gjëra të tjera të habitshme, gati të pabesueshme... se kinezët i trajtonin ish-kapitalistët në mënyrën më njerëzore: i kishin vënë nëndrejtorë në fabrikat e tyre dhe, përveç kësaj, dhe ky ishte kulmi, u jepnin një përqindje të fitimeve... [Ekremi thotë:] Sado paradoksale të duket, por midis Perëndimit dhe kinezëve unë do të zgjidhja kinezët, dhe kjo jo se nuk e dua Perëndimin, përkundrazi, sepse e dua shumë, dua ta kem në një formë sa më të sigurt... një Perëndim i veshur me rroba socialiste do të ishte për mua më i mbrojtur, më i vërtetë se ç'është ai në Evropë, i zhveshur, i mirëfilltë... Një Perëndim i tillë na duhet neve, me hilerë, me maskë, ndryshe do të jemi përherë të rrezikuar. Veç kësaj, edhe Perëndimi ndoshta s'do të na pëlqente më, ne jemi plakur, kemi ndryshuar, s'jemi më për Evropën e mirëfilltë... Shansi ynë i vetëm qenë kinezët.”⁴³

Duket sikur edhe përkrahësit e revizionizmit në dy romanet e Kadaresë synojnë pikërisht të njëjtën gjë: të ruajnë fasadën e socializmit, por t'i jepet fund ngadalë revolucionit. Edhe pse nuk bashkëpunojnë me klasat e përmbysura, ata paraqiten si më të rrezikshëm, sepse janë pjesë e parisë socialiste dhe përkrahen prej “supershteteve” socialiste: anëtarja e byrosë politike guxon të kundërshtojë në plenum qëndrimin e partisë ndaj udhëheqësjes së Bashkimit Sovjetik, ndërsa Ministri D, i nxitur nga kryeministri kinez, guxon të përfshijë në lojërat ushtarake rrethimin me tanke të një komiteti partie. Prandaj, lufta e klasave

⁴³ Kadare, *Koncert në fund të dimrit*, f. 381-382, 652-653.

zhvillohet edhe në gjirin e partisë dhe këtë familjet me tradita komuniste e marrin të mirëqenë, si pjesë normale të jetesës së tyre. Nëse një komunist përjashtohet nga partia e dënohet, pasoja vuan e gjithë familja e tij dhe farefisi largohet prej tyre, si të kenë një sëmundje ngjitëse: “Së shpejti, ju do të largoheni nga unë si nga murtaja”,⁴⁴ u drejtohet pa zë kushërinjve të saj anëtarja e byrosë politike që përjashtohet nga të gjitha funksionet partiake e shtetërore. Në albumin e fotografive të Bermemave portretet e anëtarëve të partisë që janë përjashtuar në kohë kthesash politike – plenumi i 11-të i vitit 1948, ngjarjet e Hungarisë të vitit 1956 – janë mbuluar me njolla me bojë.⁴⁵ I gjithë fisi shqetësohet kur merret vesh se një vajzë e xhaxhait të Diana Bermemës dëshiron të fejohet me djalin e një të përjashtuari nga partia në Konferencën e Tiranës të vitit 1956. Ata mblidhen nëpër shtëpitë e njëri-tjetrit për të diskutuar çështjen.⁴⁶

Kur Saimir Krasniqi i tregon Silvës se e kanë përjashtuar nga partia, ai megjithatë përpiqet ta qetësojë motrën se familja e kësaj nuk ka se si të preket. Ndërsa ai vetë “do të fillonte të mënjanohej dalëngadalë, si pa kuptuar, nga jeta, siç bënin zakonisht të përjashtuarit nga Partia”.⁴⁷ Kur Saimiri më pas arrestohet, Silva mendon se familja e saj ndodhet para një humnere që s’i dihet fundi. Si fillim, Gjergjit, si anëtar partie, do t’i duhet t’i tregojë organizatës bazë të ministrisë së jashtme se kunati i tij është përjashtuar nga partia dhe është arrestuar. Nëse kunati dënohet, Gjergjin mund ta lëvizin në një pozicion pune më të ulët. Vajzën

⁴⁴ Kadare, *Vepra letrare* 7, f. 279.

⁴⁵ Po aty, f. 284-285.

⁴⁶ Po aty, f. 43-44.

⁴⁷ Kadare, *Koncert në fund të dimrit*, f. 170.

e tyre, Brikenën, kur të rritet do ta ndjekë nga pas hija e dajës së dënuar në autobiografitë që do të dorëzojë në institucione. Vizitat familjare te shtëpia e Saimirit do t'i rrallojnë ose ndërpresin fare, Saimirin mund ta lerë e shoqja.⁴⁸ Silva e ndjen se do t'i ndryshojë bota e saj e brendshme dhe pamja e jashtme, sepse edhe ato varen nga biografia familjare. Dikur “edhe pamja e saj, e sidomos e së motrës... sjelljet e tyre të lirshme, veshjet, çiltërsia etj., merrnin vlerën e tyre të plotë në sfond të asaj biografie”.⁴⁹ Si për të treguar se tani Silva Krasniqi po futet në botën paralele të të deklasuarve, asaj i behin në shtëpi teza tjetër, ajo që është martuar në një familje të deklasuar, e shoqëruar nga burri, vajza e vogël dhe kunata. Është hera e parë që Silva sheh nga afër burrin e tezes dhe takon motrën e këtij, për herë të parë Brikena sheh kushërirën. Silvës nuk i duhet shumë për të kuptuar arsyen e ardhjes së tyre në banesën e saj: “Tani u bëmë njëlloj... mund të shkojmë për vizitë te njëri-tjetri”.⁵⁰ Mirëpo Silva nuk pranon që ta thithë bota e të deklasuarve. Për të hequr ankthin e shkaktuar nga vizita e familjes së tezes, ajo shkon me Gjergjin në një mbrëmje në ministrinë e punëve të jashtme. Me shpirtin e ngritur nga atmosfera e atjeshme ajo sigurohet se cilës botë i përket: “Kjo ishte bota e saj dhe askush nuk kishte të drejtë t’ia hiqte. Dhe askush nuk do të mundte asnjëherë. Dhe befaz vizita e pasdites... iu duk e largët, e shurdhët si nga një tjetër galaktikë.”⁵¹

Lufta e klasës ashtu siç përshkruhet në dy romanet e Kadaresë ngjan me një bisturi kirurgjikale që ndan më dysh

⁴⁸ Po aty, 211-212, 214.

⁴⁹ Po aty, f. 225.

⁵⁰ Po aty, f. 250.

⁵¹ Po aty, f. 261.

shoqërinë e familjet, duke veçuar mishin e huaj prej organeve vitale, pa gjakderdhje të tepërt e pa ndërlkime pasoperacionale. Personazhet e deklasuar në të dy romanet jetojnë më vete, ata kanë humbur pronat e dikurshme, por nuk duket se kanë privime materiale krahasuar me pjesën tjetër, përveç mos-daljes së të drejtës së studimit. Disa prej tyre kanë vuajtur dënime me burg, por më pas po të tregojnë kujdes dhe të mos flasin kundër regjimit, nuk do të merret njeri me ta. Ata që dënohen nga partia lënë skenën në heshtje, duke u pajtuar me faktin se të afërmit do t'i largojnë dhe do t'ua nxijnë fytyrat në fotografitë familjare. (Gjithsesi, familjarët do të kujtohen për ta sa herë që do të hartojnë biografitë e kërkuara nga entet shtetërore e partia.) Organet e diktaturës së proletariatit veprojnë me drejtësi: akuzat ndaj Saimirit bien dhe është Ministri D ai që shumë shpejt do të merret i pandehur. Përgjegjësit e terrorit të viteve të para të pushtetit janë dënuar dhe mënjanuar nga organet qendrore të pushtetit. Megjithatë disa nga këta marrin zemër nga prishja e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik e mendojnë se “liberalizmi” do të përfundojë dhe do të vijë sërish koha e tyre. I tillë është Arianit Çorraj, që punon si magazinier në një ndërmarrje të vogël, por më parë ka qenë ish-punonjës në Ministrinë e Brendshme në kohën e Koçi Xoxes. Ai e quan veten besnik të partisë dhe mendon se “shkrimtarët”, fjalë që e përdor për të emërtuar të gjithë intelektualët, janë e keqja e socializmit. Arianiti i shkruan një letër Enver Hoxhës ku i propozon rinisjen e metodave të vitit 1947. Kjo do të thotë që revolucioni të bëjë prapakthesë te një stacion i tij i dikurshëm, që partia më pas e ka quajtur devijim të gabuar. Prandaj, personazhi Enver Hoxha acarohet nga letra, megjithatë ai gjykon se më të rrezikshëm se

Arianiti janë ata burokratë që maskohen pas fjalëve të zjarrra për klasën punëtore, ndërsa tinëz punojnë për pushtetin e tyre. Si për t'ia ngushtuar lakun këtyre elementëve, diktatori miraton zvogëlimin e rrogave të zyrtarëve të lartë të shtetit e të partisë, pa harruar as të vetën.⁵²

IV. Pas Kinës, Evropa?

Në romanin *Dimri i madh* janë të shpërndarë metafora dhe alegori që Bashkimin Sovjetik e shfaqin jo më si vendin e parë socialist dhe udhëheqës të kampit të shteteve socialiste të botës, por si trashëgimtarin e Perandorisë Ruse. Edhe pse udhëheqësit komunistë rusë vijojnë t'i referohen Leninit dhe solidaritetit socialist, nën këtë retorikë sipërfaqësore personazhet shqiptare shquajnë shenjat e perandorisë ortodokse e pansllave: kupolat e kishave bizantine me “prarim aziatik” dhe gjuhën starosllavjane, apo mësimin në shkollë të “profecisë” së “tri Romave” të murgut Filofei, sipas së cilës Moska i ka zënë vendin Romës dhe Konstandinopojës.⁵³ “A ua treguam vendin, ashtu siç duhet, bizantinëve”, pyet Viktori i entuziazmuar Besnikun dhe ky i fundit mendon se shteti i madh socialist tani është një Perandori Bizantino-Tartare që shumë shpejt do të burgosë shkrimtarët dhe do të pushtojë vende të tjera.⁵⁴ “Po i tregon dhëmbët perandoria”, thotë një nga anëtarët e delegacionit shqiptar kur disa gjeneralë të ushtrisë sovjetike grumbullohen afër tyre; Enver Hoxha mendon se “mbi trupin dyzetvjeçar të Bashkimit Sovjetik po

⁵² Kadare, *Vepra letrare* 7, f. 426-433.

⁵³ Po aty, f. 126-127, 144

⁵⁴ Po aty, f. 343, 567.

dilnin thinjat e perandorisë”; ndërsa Ana dëgjon në radio se udhëheqësit sovjetikë tani quhen “carët e rinj të Kremlinit”.⁵⁵ Me braktisjen e komunizmit duket sikur Bashkimi Sovjetik po shkon mbrapa në kohë dhe po tërhiqet në Azi, në strehën e despotizmit oriental, për të cilin ka shkruar dhe Marksi. Nënkuptohej se, duke mos hequr dorë nga komunizmi (stalinizimi), Shqipëria qëndron në të tashmen dhe në Evropë.

Orientalizmi i Kadaresë është më i drejtpërdrejtë te *Koncerti*, i ndihmuar prej pozicionit gjeografik të Kinës në Lindjen e Largët, ndërkohë që Bashkimi Sovjetik shtrihet edhe në Evropë. Evropa del si një njësi e vetme kulturore që duhet mbrojtur prej “duhmave aziatike” që shkatërrojnë dhe dystojnë gjithçka.⁵⁶ Një “duhmë aziatike” po përgatit personazhi Mao Ce Dun, udhëheqësi i Kinës socialiste. Ai nuk druhet të thotë se komunizmi mund të vonojë në botë 10,000 vjet,⁵⁷ prandaj i ka lënë mënjanë klasikët e marksizëm-leninizmit dhe, në vend të tyre, lexon shkrimet e murgjve tibetianë. Mësimet e eremitit Milarepa i ka futur në këshillat për komunistët dhe në rregulloren e ushtrisë. Adhuruesit e Maos anembanë botës më kot mundohen ta zbërthejnë mendimin e këtij me anë të shkrimeve të Marksit, sepse Maoja synon të ndjekë shembullin e Xhenxhis Khanit,⁵⁸ themeluesit të perandorisë më të madhe tokësore, e cila përfshinte pjesën më të madhe të Azisë dhe një pjesë të Evropës.

Mirëpo ambicia e Maos është më e madhe dhe metoda e tij është e ndryshme nga ajo e Xhenxhis Khanit. Maoja dëshiron të

⁵⁵ Po aty, f. 144, 432, 587.

⁵⁶ Kadare, *Koncert në fund të dimrit*, f. 133.

⁵⁷ Po aty, f. 284.

⁵⁸ Po aty, f. 133.

sundojë gjithë botën dhe metoda e tij është origjinale: përhapja e marijuhanës që të prapësojë zhvillimin e madh që ka marrë intelekti njerëzor, madje zëvendësimin e gjinisë njerëzore me njeriun e ri, Lej Fenin, që do të ketë një tru më të thjeshtë. Trullosja e njerëzimit duhet të nisë nga Evropa, sepse “truri i Evropës është më i keqi nga të gjithë... trulloj një herë Evropën dhe zëre se ke trulloj botën”.⁵⁹ Përhapja e marijuhanës do të shoqërohet me shkatërrimin e sistemit shkollor, zhdukjen e universiteteve, pakësimin e librave, dënimin e shkrimtarëve, ndalimin e arteve, madje edhe me reduktimin e dashurisë të akti seksual. Dashurinë ai e quan epideminë më të përhapur të njerëzimit, që kishte lindur nga Rilindja Evropiane, por që Maoja do ta luftojë me shumë mënyra, përfshirë dhe çgrarëzimin e grave me anë të zhdukjes së gjithçkaje që tek ato nxiste pasionin e dashurisë: këpucët e grave, bizhutë, fustanet, krehjet e flokëve, siç po bënte tashmë në Kinë dhe Kamboxhia.⁶⁰ Sulmi aziatik i Maos shënjestron Evropën dhe njeriun e bardhë, Shqipëria shërben si trampolinë e tij:

“Ai u përpoq të sillte ndër mend procesin e ardhshëm të kinezifikimit të Shqipërisë. Pas zhdukjes së inteligjencies dhe përçudnimit të shkollës, do të vinte zbehja e historisë, harresat e mëdha, zëvendësimi i heronjve dhe lindja e Lej Fenëve të parë shqiptarë... Rezerva e evropianizmit të tyre do pakësohej dalëngadalë, si uji në një kështjellë të rrethuar. Atëherë edhe një sulm i fundit dhe Shqipëria do të jepej... Gati shtatë shekuj më parë Azia, për herë të parë, ia kishte vënë syrin këtij vendi. Ajo kishte mundur më në fund ta fuste

⁵⁹ Po aty, f. 124.

⁶⁰ Po aty, f. 129-130.

në gjirin e saj, ku e kishte mbajtur pesë shekuj. Por Shqipëria, si një mace e egër, kishte mundur prapë t'i ikte Azisë në fillim të shek. XX. Por kjo ishte hera e fundit që ndodhte një gjë e tillë. Tani ajo nuk kishte ku të vinte më. Shurdhtazi, pa shpatë e pa bujë, ajo do t'i kthehej Azisë, këtë herë përjetë. Ky do të ishte një moment sublim në historinë mijërvjeçare të Kinës. Vendi i parë evropian në botë që do të kinezifikohej. Si njolla e vitiligos, kinezizimi do të përhapej ngadalë në veri të saj, drejt Evropës Qendrore, e pastaj edhe më larg. Kjo do të ishte fitorja e parë kolosale e Azisë mbi Evropën. Revanshi mijërvjeçar. Ky ishte në të vërtetë thelbi i veprës së tij.”⁶¹

Bashkëshortja e Maos, Çian Çini, propozon që goditja ndaj dashurisë të fillojë me gratë shqiptare: “[Ato] do të jenë të parat që do të zhgrarizohen në kontinent. Me ç’kam dëgjuar, islami u hodhi ferexhenë për pesëqind vjet, megjithatë shpëtuan prej saj. Po ne jemi më të fortë se islami.”⁶² Në kohën kur Maoja dhe Çian Çini gëzohen që maoistët gjenden në mesin e Evropës, mu në Paris, grave shqiptare në Tiranë do t’u duhet ta mbrojnë dashurinë, jo vetëm për veten e tyre, por edhe për gratë evropiane dhe të të gjithë botës. Kjo nuk do të thotë që Shqipëria do ta braktisë socializmin dhe do të përqafojë kapitalizmin, siç ëndërrojnë borgjezët e dikurshëm në bodrumet e Tiranës. Këta të fundit qahen se nuk janë më të denjë për “Evropën e mirëfilltë” (kapitaliste), prandaj zgjedhin socializmin kinez. Perëndimi dërgon në Shqipëri tregtarë e turistë me flokë e mjekra të gjata

⁶¹ Po aty, f. 55-56.

⁶² Po aty, f. 131.

për të testuar klimën politike në vend, por ata në aeroportin e Rinasit priten nga berberi që ka detyrën të qethë e të rruajë vizitorët e huaj për t'ua përshtatur pamjen e tyre të jashtme moralit komunist.⁶³ Pra, Shqipëria socialiste refuzon kapitalizmin, por ajo është vija e parë e mbrojtjes së kulturës evropiane prej kërcënimit të barbarisë aziatike.

Koncerti u ndalua në fillim të viteve 1980, por u lejua të botohej në vitin 1988. Ndër argumentet që shkrimtari Dritëro Agolli jepte në vitin 1983 për ndalimin e botimit të veprës, janë se kjo ishte një satirë e përqeshje e komunizmit nga pozitat e një liberali evropian; se në të gjendej ideja e gabuar e luftës së Azisë kundër Evropës, që nuk kishte të bënte me luftën e marksizëm-leninizmit kundër revizionizmit e ekstremizmit të partisë komuniste kineze; se në të kinezët dhe aziatikët paraqiteshin inferiorë ndaj evropianëve dhe të paaftë për ide përparimtare; se populli shqiptar në këtë roman dilte sikur nuk e donte miqësinë me Kinën, por ia impononte partia dhe shteti; se shumica e personazheve ishin mikroborgjezë dhe bartës të liberalizmit dhe anarkizmit. Ai në fund shtonte se Kadareja e kishte shkruar romanin për publikun e huaj dhe për të bërë bujë politike jashtë vendit.⁶⁴ Agolli ka të drejtë për mënyrën se si kinezët portretizohen në romanin e Kadaresë dhe një kritikë si e atij do të qëndronte edhe sikur romani të ishte botuar pas rënies së komunizmit, mirëpo Agollit dhe recesentëve të tjerë të romanit në atë kohë nuk u bënte përshtypje se Kadareja në mënyrë të

⁶³ Po aty, f. 666.

⁶⁴ “Mendime të Dritëro Agollit lidhur me romanin ‘Gjakftohtësia’ të Ismail Kadaresë”, në Meta, Krasniqi dhe Bello, red., *Indoktrinimi komunist përmes kulturës letërsisë dhe artit (dokumente arkivore)*, vëll. 4, f. 313-323.

ngjashme orientalizonte edhe klasat e përmbysura e i bënte ato bashkëfajtores për tentativën e “kinezifikimit” të Shqipërisë.

Por, nëse në vitin 1983 romani i Kadaresë nuk botohej, sepse konsiderohej si shprehje e ideologjisë borgjeze në mesin e intelektualëve, çfarë e bën të njëjtin roman të botueshëm pesë vite më vonë? Mendojmë se janë ndryshimet që kishin ndodhur në Evropë dhe Shqipëri që nga mesi i dekadës. Mihail Gorbaçovi kishte nisur reformat në Bashkimin Sovjetik dhe vendet satelite kishin fituar një liri më të madhe në marrëdhëniet e tyre me shtetet e Evropës Perëndimore. Intelektualë disidentë në Çekosllovakia, Hungari e Poloni flisnin dhe shkruanin hapur për shkëputje nga ndikimi i Bashkimit Sovjetik. Ata ringjallën konceptin e “Evropës Qendrore”, me të cilin kuptohej një zonë gjeopolitike me lidhje të fuqishme kulturore me Perëndimin, por që ndodhej nën sundimin e Lindjes. Disidentët përfaqëuan një “orientalizëm kundërkomunist”,⁶⁵ si ai që do të kthehej në ligjërimin hegjemonist në Shqipërinë e viteve 1990.⁶⁶ Te ideja e Evropës e elitës politike dhe intelektuale paskomuniste në Shqipëri kemi vazhdimësinë e orientalizmit komunist kundrejt trashëgimisë osmane të vendit, të ndërthurur me orientalizmin kundërkomunist, i cili te sistemi i përmbysur socialist shquante llojin më të fundmë dhe më të zhvilluar të “despotizmit oriental”.

⁶⁵ Natasa Kovacevic, “Anticommunist Orientalism: Shifting Boundaries of Europe in Dissident Writing” [“Orientalizmi kundërkomunist: Kufijtë e lëvizshëm të Evropës në shkrimet e disidentëve”], në Bradatan, Costica dhe Serguei A. Oushakine, red., *In Marx's Shadow: Knowledge, Power and Intellectuals in Eastern Europe and Russia* [Në hijen e Marksit: Dija, pushteti dhe intelektualët në Evropën Lindore dhe Rusi], New York: Lexington Books, 2010, f. 131-152.

⁶⁶ Shih Sulstarova, *Arratisje nga Lindja*, f. 223-291.

Refuzimi i Lindjes, si antitezë e Perëndimit, do të shërbente për legjitimimin e shndërrimeve socio-ekonomike të tranzicionit, ku horizonti i integritit (përfundimtar) me Perëndimin do të zëvendësonte atë të arritjes së komunizmit. Pra, *Koncerti* në fund të viteve 1980 i ofronte publikut vendas dhe atij perëndimor një përfytyrim për Shqipërinë që i ngjante atij të “Evropës Qendrore” si një rajon që i përkiste zonës së kulturës evropiane, por që mbahej i ndarë prej saj nga Lindja komuniste. Kadareja e quan Evropën si trurin e botës – me siguri duke i bërë jehonë Paul Valery-së, i cili pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore shkruante që Evropa ose do të mbetej truri i botës ose do të bëhej thjesht një kep i kontinentit të Azisë – dhe ai e cilëson Evropën Qendrore si rajonin evropian më të rrezikuar nga kinezifikimi, pas Shqipërisë. Prandaj, botimi i *Koncertit* në vitin 1988 nga shtëpia botuese shtetërore, mund të lexohet si një pohim se tashmë loja kishte përfunduar me fitoren e botës perëndimore.

Për qëllimin e artikullit tonë, ia vlen të bëhet edhe pyetja se kë *nuk* orientalizon Kadareja te *Koncerti* dhe pse? Sigurisht që ai nuk orientalizon personazhet kryesore të shtresës burokratiko-intelektuale, me të cilën identifikohet autori dhe që portretizohet si shtresa më moderne e vendit. Personazhe si Ana dhe Silva Krasniqi, përfshirë edhe Besnik Strugën nga romani *Dimri i Madh*, janë lindur apo formuar gjatë socializmit, në familje që ia detyrojnë ngritjen shoqërore sistemit socialist. Ata nuk kanë nostalgji për kohën para Luftës dhe as simpati për “borgjezinë e zezë”, prandaj atyre mund t’u besohet stafeta e drejtimit të vendit dhe orientimit për nga Evropa. Në faqet përmbyllëse të librit autori ka vendosur në trurin e personazhit Enver Hoxha mendime mbi kalimin e stafetës së socializmit te brezi i ri dhe lidhjen e

historisë së Shqipërisë me atë të Evropës: “E kthjellët, pas njëzet shekujsh mundimesh, ajo [Shqipëria] do të gdhinte në mijëvjeçarin e tretë të historisë së kontinentit, që ishte njëkohësisht i treti mijëvjeçar i saj.”⁶⁷ Pasi e mendon këtë fjali monumentale, personazhi i diktatorit nuk del më në roman. Alia, të cilit i kaloi udhëheqja e diktaturës, në fund të viteve 1980 nisi një liberalizim tepër të kontrolluar në rrafshin e ekonomisë dhe të kulturës, ndërsa zyrtarisht refuzonte idenë që socializmit në Shqipëri po i vinte fundi. Vendimi për ta botuar romanin e Kadaresë në vitin 1988, vit në të cilin përfundoi edhe muzeu i Enver Hoxhës në Tiranë, mund të ketë qenë pjesë e kësaj strategjie për zbatimin e reformave drejt ekonomisë (të kufizuar) së tregut me ndihmën e “borgjezisë së kuqe”. Gjithsesi, ngjarjet u rrokullisën me shpejtësi drejt fundit të sistemit dhe vetë Kadareja, në shenjë proteste ndaj inercisë së regjimit, në tetor 1990 kërkoi azil politik në Francë. Shtresa e burokratëve dhe e intelektualëve të regjimit komunist udhëhoqi procesin e tranzicionit, duke nxjerrë prej vetes dhe klasën e kapitalistëve të rinj, sikurse ndodhi edhe në vendet e tjera të Evropës Lindore.

V. Përfundim

Romanet *Dimri i madh* dhe *Koncert në fund të dimrit* të Ismail Kadaresë kanë në qendër fundin e aleancave të Shqipërisë socialiste me “supershtetet” Bashkimi Sovjetik dhe Republika Popullore e Kinës. Sigurisht që mesazhi qendror i tyre është marshimi i vetmuar i Shqipërisë drejt komunizmit, mirëpo, meqenëse romani është një gjini shumëzërëshe, autori ka

⁶⁷ Kadare, *Koncert në fund të dimrit*, f. 671.

shfrytëzuar rastin që të paraqesë te veprat e tij rrugë alternative: fundin e socializmit, që nënkupton dhe përqaftimin e kapitalizmit, ose liberalizimin e sistemit totalitar. Fundin e socializmit ai e vë në gojë e personazheve që përfaqësojnë borgjezinë e përmbysur. Këta e dëshirojnë fundin e socializmit dhe rimarrjen e pronave dhe ofiqeve të dikurshme, por gjithashtu e dinë se nuk mund ta kryejnë kundërrevolucionin, prandaj shpresojnë se ndërprerja e ndihmave dhe kredive prej kampit socialist do ta detyrojë udhëheqjen komuniste t'i drejtohet për ndihmë Perëndimit. Në fund ata urojnë që socializmi shqiptar t'i ngjajë atij kinez, meqenëse supozohet se sillet më butë me ish-borgjezët. Në këtë mënyrë, të deklasuarit në penën e Kadaresë përveçse shfaqen si të vjetëruar dhe anakronikë në raport me shoqërinë moderne socialiste, orientalizohen edhe më tej si përkrahës të një supershteti aziatik që kërkon të nënshtrojë një shtet evropian.

Alternativa e liberalizimit të diktaturës është më e mundshme të realizohet. Skenat e jetës së përditshme të jetesës komode dhe të gëzueshme të personazheve nga shtresa burokratiko-intelektuale, që i ngjajnë jetesës së shtresës së mesme në Perëndimin kapitalist, sado që nuk janë pasqyrim i realitetit të viteve 1960-1970 në Shqipëri, sidomos po të kemi parasysh kushtet e jetesës së masave punëtore dhe fshatare, shërbejnë për të treguar se socializmi ka legjitimitet të gjerë në shoqërinë shqiptare. Ndërsa të deklasuarit nuk paraqiten si rrezik real, burokratizimi mund ta degradojë sistemin, prandaj duhet mbajtur një vigjilencë e përhershme ndaj daljes së një “borgjezie të kuqe”. Sidoqoftë, tentativa e Ministrisë D të *Koncerti* është aq e mefshët, sa që më shumë se pasqyrim letrar i zbulimit të “grupit puçist” në ushtri në vitet 1970, ajo duket sikur është futur nga

autori për të krijuar një dramë në jetën e qetë të familjes së Silva Krasniqit. Besimi te partia mbetet i palëkundur dhe ashpërsimin e luftës së klasave kundër shtresës burokratiko-intelektuale e kërkojnë elementë të shkëputur e ekstremistë që partia i ka dënuar e mënjanuar me kohë nga pozitat drejtuese. Në këtë mënyrë, dy romanet e Kadaresë mund të trajtohen si shprehje të frymës liberale në mesin e shkrimtarëve dhe artistëve, ose shtresës më të gjerë të atyre intelektualëve shqiptarë të formuar gjatë viteve të socializmit. Gjithsesi, të dy romanet paraqesin kontradiktën në jetën e përditshme midis autonomisë individuale dhe kontrollit familjar dhe politik. Dëshira e individëve të shtresës burokratiko-intelektuale për të vendosur për veten ndeshet me përgjegjësinë konstante që ata mbartin për farefisin dhe që është e stimuluar nga biopolitika e regjimit. Edhe të deklasuarit në sferën e tyre të ndarë, ku mundësitë për përparim shoqëror janë vetvetiu të kufizuara, prapëseprapë jetojnë të terrorizuar prej mundësisë së ashpërsimit të beftë të luftës së klasave.

Pas rënies së diktaturës, Kadareja do ta paraqesë komunizmin si një forcë orientalizuese që e shkëputi Shqipërinë nga zhvillimi evropian, pra si një episod të dytë lindor pas shkëputjes nga Perandoria Osmane. Në romanet *Dimri i madh* dhe *Koncert në fund të dimrit* ai orientalizon të deklasuarit, Bashkimin Sovjetik dhe Kinën komuniste, duke e paraqitur Shqipërinë si një vend që e lufton revizionizmin edhe për shkakun se ai i përket zonës kulturore evropiane. Duket se degjenerimi i regjimeve komuniste në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë buron prej impulseve perandorake e despotike që vijnë nga thellësia historike e dy shteteve. Ndërsa, shqiptarët, ngaqë arritën

të ruajnë rezervat e evropianitetit nën acarin osman, janë imunë prej përpjekjeve kolonizuese sovjetike e kineze. Te *Koncerti*, i botuar në vitin 1988, referencat te “Evropa” dhe te përkatësia evropiane e shqiptarëve janë më të drejtpërdrejta sesa te *Dimri i madh*, aq sa duket se janë vënë enkas nga autori si një ftesë për të orientuar parinë komuniste që t’i jepte fund vetizolimit.⁶⁸

Referenca

- Balockaite, Rasa. “Bourgeoisie as Internal Orient in the Soviet Lithuanian Literature: *Roses are Red* by A. Biekauskas, 1959” [“Borgjezia si Orient i brendshëm në letërsinë lituaneze sovjetike: *Trëndafilat janë të kuq* nga A. Biekauskas, 1959]. *Journal of Baltic Studies* [Revista e studimeve baltike], vëll. 47, nr. 1, 2016, f. 77-91.
- Champseix, Jean-Paul. *Ismail Kadare: Një disidencë letrare*. Tiranë: Fan Noli, 2021.
- Clark, Katerina. *The Soviet Novel: History as Ritual* [Romani sovjetik: Historia si ritual]. Chicago: The University of Chicago Press, 1981.
- Dede, Spiro. *Kundërrevolucion në kundërrevolucion*. Tiranë: 8 Nëntori, 1983.
- Dervishi, Met. *Intertekstualja dhe disidentja te Dimri i vetmisë së madhe*. Tiranë: Saras, 2014.
- Historia e PPSH*. Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, 1983.
- Hoxha, Enver. *Vepra, vëllimi 51: Maj 1973-qershor 1973*.

⁶⁸ Autori falënderon Jonida Gashin dhe Ylber Markun për komentet e tyre për një variant të mëparshëm të artikullit.

- Tiranë: 8 Nëntori, 1986.
- Kadare, Ismail. *Vepra letrare 7: Dimri i madh*. Tiranë: 8 Nëntori, 1981.
- . *Koncert në fund të dimrit*. Tiranë: Naim Frashëri, 1988.
- Kovacevic, Natasa. “Anticommunist Orientalism: Shifting Boudaries of Europe in Dissident Writing” [“Orientalizmi kundërkomunist: Kufijtë e lëvizshëm të Evropës në shkrimet e disidentëve”]. Në *In Marx’s Shadow: Knowledge, Power and Intellectuals in Eastern Europe and Russia* [Në hijen e Marksit: Dija, pushteti dhe intelektualët në Evropën Lindore dhe Rusi], red. nga Costica Bradatan dhe Serguei A. Oushakine, New York: Lexington Books, 2010, f. 131-152.
- Meta, Beqir, Afrim Krasniqi dhe Hasan Bello, red. *Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit (dokumente arkivore)*, vëll. 4, 1997-1984. Tiranë: Emal, 2021.
- Meta, Beqir, Marenglen Verli dhe Muhamet Jashari, red. *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX, vëllimi 5*. Tiranë: Botimet Albanologjike, 2023.
- Mëhilli, Elidor. *From Stalin to Mao: Albania and the Socialist World* [Nga Stalini te Mao: Shqipëria dhe bota socialiste]. Ithaca: Cornell University Press, 2017.
- Prifti, Peter R. *Socialist Albania since 1944: Domestic and Foreign Developments* [Shqipëria socialiste që nga viti 1944: Zhvillime të brendshme dhe të jashtme]. Cambridge (MA): The MIT Press, 1978.
- Sulstarova, Enis. “Lufta e klasave përmes realizmit socialist: Rasti i romaneve e novelave me agjenturë”. *Politikja*, vëll. 2, 2017, f. 109-135.

ENIS SULSTAROVA

———. *Arratisje nga Lindja: Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*. Tiranë: Pika pa sipërfaqe, 2019.

Shaplo, Dalan. *Vështrime teorike-letrare*. Tiranë: Naim Frashëri, 1978.